



**BASHKIA
TIRANË**

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 7 datë 11.03.2016

Për

“PËR VENDOSJEN E BUSTIT TË PAPA FRANÇESKU NË NJË NGA MJEDISËT E QYTETIT TË TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 9/1.7 shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ll” dhe nenit 55 pika 2 të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”, neni 31 i “Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak”; Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin për vendosjen e bustit të Papa Françeskut, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë vendosjen e bustit të Papa Françesku në mjedisin lulishte pranë simbolit të Këmbanës së Paqes.
2. Ngarkohet Drejtoria e Punëve Publike për realizimin e bazamentit të monumentit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

ALDRIN DALIPI